



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. 1336/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me sekretaren juridike Ujëvesa Hysenaj, në konfliktin administrativ të paditësit F.B., nga komuna e F., kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli Kombëtarë për Njohje, Prishtinë, baza juridike anulimi i aktit administrativ, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, me dt. 13.04.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit F. B. **Anulohet** vendimi “Përgjigje në Ankesë” i dt. 21.09.2012 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, të thirrur në mënyrë të rregullt.

Paditësi F.B., në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se qëndron pranë padisë dhe kërkon gjykatës që të anulohet vendimi “përgjigje në ankesë” e shkallës së dytë “mos njohje të diplomës të fituar në Universitetin A.Gj.”, i dt. 21.09.2012, të paditurit të Këshillit Kombëtar për Njohje në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ashtu që do ta detyroj të paditurën që të nxërë vendim të ligjshëm duke i njohur të drejtën e gradës “Doktor i Administrimit të Biznesit” të fituar në SMC- University. Me tutje shton se, vendimi është marrë jashtë afateve ligjore të cilët janë të specifikuar në nenin 10 pika 1 të Udhëzimit Administrativ nr.08/2010, dhe se është shkelur parimi i dyshkallëshmërisë, në këshillën juridike është udhëzuar që ankesa të paraqitet në Këshillin e Ankesave në MASHT, por ankesën tij nuk e ka trajtuar komisioni i ankesave por kryetari i Këshillit Kombëtar për Njohje, i cili është organi i njëjtë që e ka marrë edhe vendimin e shkallës së parë. Më në fund, shton se mastarin e ka përfunduar në Amerikë dhe është nostrifikuar nga Këshilli Kombëtar për Njohje, që është bazuar nga akreditimi i QEA-së, dhe njëheri shton se nuk është respektuar Ligji për Arsim të Lartë me nr. 04/ L /037, respektivisht neni 3 pika , 1.16.

E autorizuar e të paditurës Nexhmije Karaqa, me parashtresën e dt. 24.03.2016, e ka njoftuar gjykatën se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadisë e paditësit, t'a refuzon në tërësi si të pabazuar, duke e lënë në fuqi vendimin e të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 13.04.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: ankesa e dt. 09.08.2012, përgjigja në ankesë ndaj vendimit për mosnjohje të diplomës të fituar në universitetin A. Gj. i dt. 21.09.2012; vendimi 10.05.2012, me nr. 6-2557; vendimi i dt. 21.09.2012, nr. 6-2557; ankesa 14.08.2012; QEA e data baza of program Council for Higher

Education Accreditation; shkresa e dt. 30.04.2014; e-maili i dt. 29.04.2014; e-maili i dt. 12.10.2012; web-faqe të Academic accreditation in Switzerland, Validity of degrees issued private institution in Swiss.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga vendimi “Përgjigje në ankesë” i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar.

Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekën në një mënyrë apo tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Më tutje, neni 86 të po këtij ligji përcakton se Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshij shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike.

Andaj, vendimi “Përgjigje në ankesë” i kundërshtuar është juridikisht jo i qartë dhe i nijeti vendim në arsyetimin e tij përmban një formulim të përgjithshëm dhe abstrakt, ku thuhet se ankesa e juaj e dt. 09.08.2012, numër 6-2557 është shqyrtuar nga ana e Këshillit Kombëtarë për Njohje në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.07.2013. Këshilli konstaton se vendimi për mosnjohje të gradës së juaj “doktor” është marr duke u mbështetur në përgjigjen e qendrës ENIC/NARIC të Zvicrës me të cilën thuhet se ‘S. M. C.’ nuk është e akredituar nga Agjencia për Akreditimin të Arsimit të lartë në Zvicër dhe akreditimet nga ndonjë shtet i jashtëm nuk akreditohet. Me tutje, citohet se ankesën e juaj nuk është ofruar dëshmi që e argumenton të kundërtën, dhe se vendimi për mosnjohje të gradës suaj “Doktor” mbetet në fuqi. Nga kjo gjykata vlerëson se vendimi kontestues është jo i qartë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë të LPA-së, ngase nuk mund të kuptohet se me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit, cili vendim ka mbetur në fuqi dhe çka është vlerësuar nga i padituri në rastin konkret.

Po ashtu, gjykata gjen se, vendimi kontestues është nxër në kundërshtim edhe me nenin 126 pika 126.1 dhe 126.2 të LPA i cili përcakton se, *Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Ligj për ankimin administrativ. E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet në mënyrat e mëposhtme: përmes kërkesës për rishqyrtim drejtuar nëpunësit përgjegjës për aktin; përmes ankimit drejtuar organit më të lartë.*

Në bazë të vendimit të shkallës së parë dhe të dytë të paditurës, gjykata vëren se të dy vendimet si vendimi me nr. numër 6-2557 dhe "përgjigje në ankesë" i dt. 21.09.2012 janë nxjerr nga Kryetari i Këshillit Kombëtarë për Njohe, i cili organ ka vepruar si organ i shkallës së parë dhe dytë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 126 të LPA-së.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur ka bërë shkelje të Ligjit të Procedurës Administrative, përkatësisht të neneve 84, 85, 86 dhe 126, kur ka nxjerr vendimin e goditur me padi.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1336/2012-dt. 13.04. 2016

Sekretare Juridike
Ujëvesa Hysenaj

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.